

Pasojat e luftërave habsburge – osmane në strukturën demografike të Kosovës

Nehat Krasniqi

Abstrakti

Ky punim ka për objekt studimi zhvillimin dhe pasojat e luftërave habsburge – osmane në Kosovën e sotme dhe në viset e tjera etnike shqiptare të Sanxhakut dhe të Maqedonisë së sotme, në kapërcyellin e shekullit XVII dhe në katër dekadat e para të shekullit XVIII. Në këtë studim vihet në dukje roli i shqiptarëve në këto luftëra dhe, në veçanti, pasojat tejet të rënda të këtyre luftërave te popullsia shumicë shqiptare e këtyre viseve. Burime osmane, të panjohura më parë për historiografinë shqiptare dhe më gjerë, hedhin dritë të re mbi rrethanat e krijuara në këto vise në kohën e depërtimit të trupave habsburge dhe të aleatëve të tyre, gjatë tremujorit të fundit të vitit 1689. Ato hedhin dritë të re, sidomos për lëvizjet demografike dhe për shpërnguljet masive të popullsisë shqiptare myslimane nga Kosova e sotme në atë kohë. Këto burime flasin shumë qartë për një shpopullim tejet të madh të etnisë shumicë shqiptare në Kosovën e sotme dhe në viset përreth gjatë këtyre luftërave, si pasojë e shpërnguljeve, vrasjeve dhe e vdekjes nga uria, nga sëmundjet dhe nga epidemia e murtajes e pothuaj dy të tretave të popullsisë shqiptare të Kosovës së sotme në atë kohë.

Fjalë kyçe: Shqipëri, Kosovë, popullsi, Perandoria Osmane, myslimane, demografi

Fundi i shekullit XVII dhe fillimi i shekullit XVIII në tokat shqiptare paraqet një fazë shndërrimesh të rëndësishme në fushën ekonomike, politike, demografike dhe kulturore. Thelbin e këtyre shndërrimeve e përbëjnë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm që kanë ndërvepruar rastësisht, si: luftërat e gjata dhe dramatike ndërmjet Perandorisë Osmane dhe fqinjëve të saj evropianë në kapërcyellin e shekullit XVII dhe në katër dekadat e para të shek. XVIII, lëvizjet e mëdha të

popullatës, kalimi nga sistemi i pronës feudale ushtarake në atë të çifligut dhe intensivikimi e zgjerimi i marrëdhënieve tregtare monetare dhe i zejtarisë, fuqizimi ekonomik e politik i fisnikërisë shqiptare dhe i kastës drejtuese të pushtetit vendor dhe dobësimi i kontrollit të pushtetit qendror.

Burime me prejardhje evropiane, nga ato më të besueshmet, vënë në dukje se, në fund të shek. XVII, rreth tri të katërtat ($\frac{3}{4}$) e popullsisë së përgjithshme shqiptare ishin të besimit islam.¹ Ndërsa, sipas burimeve me prejardhje osmane, në territorin e Kosovës së sotme, në atë kohë, mbi tri të katërtat ($\frac{3}{4}$) e popullsisë së përgjithshme të saj ishte shqiptare e besimit islam. Një numër i konsiderueshëm pjesëtarësh të popullsisë shqiptare, në këtë kohë, kishte pozita të rëndësishme në strukturat e pushtetit qendror osman, si dhe në strukturat e pushtetit lokal, gjithandej në Perandorinë Osmane. Ndërkaq, pas disfatës së osmanëve para mureve të Vjenës, më 12 shtator të vitit 1683, u krijuan rrethana të tilla politike shoqërore në Perandorinë Osmane, të cilat mundësuan që drejtuesit e pushtetit lokal dhe komandantët e forcave të sanxhaqeve shqiptare në trojet etnike shqiptare, të jenë të gjithë shqiptarë. Pas kësaj disfate, në territorin e Kosovës së sotme, respektivisht në sanxhaqet e Dukagjinit, Prizrenit, Vushtrrisë (Vuçitërnës) dhe të Shkupit, pushtetin efektiv do ta marrin dyer të mëdha shqiptare nga radhët e oxhakërisë, si ajo e Mahmudbegollëve,² Rrotllajve,³ Kryezinjve,⁴ Gjinollëve⁵ dhe Derallëve,⁶ të cilave, bashkë me oxhaqet e tjera shqiptare, qysh në fillim të shekullit XVIII, Porta e Lartë ua kishte njohur të drejtën e trashëgimit të pushtetit dhe të ofiqeve, duke ia hapur kështu rrugën e krijimit të oxhakërisë apo fisnikërisë shqiptare.

Lajmet që vinin në trojet shqiptare nga fushëbetejat e Hungarisë, ku qytetet binin njëri pas tjetrit në duart e habsburgëve, si: rënia e një numri feudalësh shqiptarë në ato luftime, si shumica e feudalëve të oxhakut të Hoxhollëve të Dib-rës, shumica e feudalëve të Peqinit, të Shkupit etj.; ikja e një numri të konsiderueshëm feudalësh e spahinjsh shqiptarë që kishin pronat e tyre dhe që shërbenin në detyra të ndryshme atje, si të bijtë dhe familjarët e Hasan pashë Gjakovës e të tjerë; ikja e mijëra ushtarëve shqiptarë në vendlindje; si dhe lajmet për sulmet që drejtoheshin kundër territoreve shqiptare pas pushtimit të Nishit nga forcat e "Aleancës së Shenjtë" (më 24 shtator 1689), kishin krijuar një gjendje të rëndë anarkie dhe frike të popullsisë në Shqipërinë etnike dhe gjithandej në Rumeli.⁷

1 Johann Wilhelm Zinkeisen, *Osmanlı İmparatorluğu Tarihi (1669-1774)* 5, Istanbul: Yeditepe, 2011, f. 224.

2 Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII, deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017, f. 194-198.

3 Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII, deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, f. 203-204.

4 Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII, deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, f. 198-202.

5 Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII, deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, f. 204-207.

6 Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII, deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, f. 211-213.

7 Stanford J. Shaw, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë: Jehona Study Center, 2006, f. 264.

Në anën tjetër, kriza serioze e ushqimit dhe zija e bukës, e përcjellë me epideminë e murtajes, që kishte përfshirë pothuajë mbarë Perandorinë Osmane, sidomos gjatë viteve 1685-1686, la pasoja edhe te popullsia e viseve të Kosovës së sotme. Gjithashtu, u godit rëndë edhe siguria e njerëzve nga banda cubash, që u shfaqën e u forcuan me ushtarë të cilët kishin dezertuar nga frontet e luftës dhe nga repartet e tyre ushtarake.⁸

Kjo gjendje krijoi opinione dhe orientime divergjente midis popullsisë shqiptare myslimane dhe popullsisë shqiptare të krishterë, lidhur me këto luftëra të cilat kishin karakter të theksuar fetar. Rrjedhimisht, edhe veprimet dhe angazhimet e popullsisë shqiptare të besimit islam në trojet e tyre etnike, e cila, siç u tha më lart, në këtë kohë përbënte shumicën dërrmuese të popullsisë së përgjithshme shqiptare me afro tri të katërtat e saj, nuk shkuan në të njëjtin drejtim me veprimet dhe angazhimet e popullsisë shqiptare të krishterë. Derisa nga popullsia e krishterë e këtyre viseve kjo gjendje shihet si shans ideal për të ndërruar sundimtarin dhe statusin politik e social të tyre, respektivisht si çlirim, popullsia myslimane, këtë gjendje e shihte dhe e perceptonte si fatkeqësi, si pushtim. Për fat të keq, qëndrimi tejet mizor që shfaqti ushtria e “Aleancës së Shenjtë” dhe vullnetarët e saj ndaj popullsisë shqiptare myslimane, hoqi çdo dilemë të kërret dhe masat e gjera të kësaj popullsie. Në anën tjetër, edhe politika e atëhershme e Monarkisë Habsburge dhe e aleatëve të saj ndaj popullsisë myslimane të Ballkanit në përgjithësi, pasqyrohet mjaft qartë, si në veprimet konkrete ndaj kësaj popullsie, po ashtu edhe në Proklamatën e Leopoldit I, drejtuar popujve të Ballkanit, më 6 prill të vitit 1690, me të cilën i kishte grishur ata për t’u bashkuar në luftë kundër osmanëve.⁹ Nga kjo proklamatë kuptohet se Leopoldi I synonte të “*ndreqej çdo defekt*” që kishte hyrë ndër popujt e Ballkanit gjatë sundimit osman, por gjithashtu synonte edhe rikthimin e pushtetit ashtu siç kishte qenë, *de jure*, para pushtimeve osmane në vendet e Ballkanit.¹⁰ Këto synime nënkuptonin kthimin e popullsisë myslimane të këtyre vendeve në të krishterë, ose shfarosjen e saj nga trojet e veta etnike, apo edhe, siç është thënë nga ndonjë studiues, se në këtë kohë “*Austria bëri përpjekje, që në Kosovë dhe në viset përreth saj të themelonte një principatë serbe*”.¹¹

Në këto rrethana jashtëzakonisht shqetësuese për fatet e vendit, drejtuesit shqiptarë të pushtetit lokal osman, si Mahmud pashë Begolli i Pejës, Mahmud pashë Hasan-begu i Gjakovës dhe vëllai i tij, Kurt Mehmet pasha, Sijavush pasha i Bihorit, Mustafa pashë Zurnapa i Shkupit, Ali pashë Gjini e të tjerë, me forcat e tyre të armatosura (levendët), që përbëheshin kryesisht nga shqiptarë myslimanë,

8 Shaw, *Historia e Perandorisë Osmane*, f. 265.

9 *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë. Vëllimi IV (1675-1699)*. Përgatitur nga Injac Zamputi dhe Selami Pulaha, Tiranë: Akademia e Shkencave e RSP të Shqipërisë – Instituti i Historisë, f. 334-337.

10 *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë. Vëllimi IV (1675-1699)*, f. 335, 336.

11 Midhat Sertoğlu, *Resimli Osmanlı Tarihi Ansiklopedisi*, Istanbul Matbaası, 1958, f. 180.

por edhe nga shqiptarë të krishterë dhe rashanë (serbë), ishin faktorë kryesorë që realisht mund të luanin rol në zhvillimet politike ushtarake. Gjithsesi, trupat e sanxhakbejlerëve shqiptarë bartën barrën kryesore kundër depërtimeve habsburge në trojet shqiptare, në mbrojtjen e popullsisë shqiptare nga shfarosja.¹²

Pas pushtimit të Nishit, një pjesë e ushtrisë habsburge, nën komandën e Ludvigut të Badenit, ia mësyu Vidinit, kurse pjesa tjetër, nën komandën e gjeneralit Piccolomini (l. 1640 - vd. 1689), ia mësyu viseve shqiptare veri-perëndimore.¹³ Forcat habsburge, nën komandën e Pikolominit, të përforcuara edhe me forca vullnetare rashane (serbe), të cilat u treguan të vullnetshme për plaçkitje, dhunime, vrasje masive të popullsisë së paarmatosur, si dhe për djegie të shtëpive të popullsisë myslimane, e çfarëdo kombësie qoftë ajo, më 14 tetor të vitit 1689 vazhduan marshimin nga Prokupa drejt Prishtinës.¹⁴ Këto forca, siç tregojnë burimet dubrovnikase, bënë një kasaphanë të vërtetë në Jeni Pazar. “*Plaçkitën vendin, dogjën dhe i prenë të gjithë, pa marrë parasysh gjininë e moshën, kështu që atje, as sot nuk duket njeri i gjallë, por në tërë qytetin janë shpërndarë kufomat e një numër edhe më i madh është nëpër fusha të cilat janë të shkretuara, në një perimetër tri ditë rrugë*”.¹⁵ Për pasojë, në këtë kohë, Jeni Pazarit me rrethinë përjetoj një rralim ekstrem të popullsisë autoktone me etni arbërore (shqiptare).

Pas pushtimit të Jeni Pazarit, forcat habsburge dhe aleatët e tyre, të përforcuara me vullnetarë rashanë dhe shqiptarë të krishterë, zotëruan njëri pas tjetrit qytetet e Kosovës, si: Trepçën, Prishtinën, Vushtrrinë, Pejën, Gjakovën, Prizrenin, Kaçanikun, Shkupin, Kumanovën, Tetovën etj. Edhe pse zotërimi i këtyre qyteteve dhe qytezave u bë pothuaj pa ndonjë rezistencë të armatosur, popullsia shqiptare myslimane e këtyre vendbanimeve urbane, sikurse edhe popullsia fshatare, me pleq, gra e fëmijë që nuk kishin pasur mundësi të arratiseshin, apo që nuk e paramendonin se çka mund t’u ndodhte, u plaçkit, u dhunua, u përdhunua dhe u vra në mënyrë masive.

Një përshkrim me interes për rrethanat e krijuara në Prizren, me rastin e pushtimit të këtij qyteti më të madh të Kosovës nga trupat habsburge, më 6 nëntor të vitit 1689, e që mund të merret si pasqyrë pak a shumë e përafërt edhe për qytetet e fshatrat e tjera të Kosovës së sotme dhe të viseve shqiptare përreth, asokohe e paraqet autori Tahir Efendi Rrotlla, myderriz dhe myfti i Prizrenit,

12 Nikolla Jorga, *Histori e Shkurtër e Shqipërisë dhe e Popullit Shqiptar*, përktheu nga frëngjishtja: Viron Koka, Tiranë, 2004, f. 122.

13 *Historia e Popullit Shqiptar I*, Tiranë, Toena, 2002, f. 580.

14 Gligor Stanojević, *Srbija u vreme Bečkog rata (1683-1699)*, Beograd, Nolit, 1976, f. 140.

15 J. Radonić, *Dubrovačka akta i povelje*, knj, IV, sv, 1, f. 628. Cituar sipas: Gligor Stanojević, *Srbija u vreme... Vep. e cit. f. 107 / 108.*

në “Kronikën” e tij, në vargje në gjuhën arabe.¹⁶ Ky autor shqiptar prizrenas, i mirinformuar nga burimet përkatëse osmane, situatën në Prizren, në kohën e pushtimit habsburgas, e paraqet kështu:

”Qyteti im ka qenë vërtet i siguruar me gjërat e dobishme
e me diturinë, ka qenë mburrje e banorëve tanë.
Por, kur pat rënë dija dhe puna e mirë tek ne,
vërtetë u paraqitën të liga që zvogëluan çështjen tonë.
Sidomos, që kur islammohuesit austriakë sunduan
mbi çështjet e simboleve tona që kanë qenë ndër ne.

وقال الم كبحلتنا خذ بنا لنا فأوجعت أعضائي وكحللت أقدائي خذوه فقلوه لأن ذاقنا الحزب وقد أحرز الصدر وسد كبازي	فما وجه إضرابك سوطاً برحمتنا ظلمت أيتي سبي الظلم عندنا أما من أضررت وصار سيدنا ودمر أكثر كبازي إنا منا
وفي قريته رنوة جامعاً بني فما أتم الانتقام من العلما ومن كان غداً بعد دأنا	وكأفأ شهننا باجرا ما شنا أزبل وجوده باصر ا ما منا أيمان به المولى بأولي وأخرنا
مناقب جابج عقيق و تعال له وفاخ محمد خان بذية محمد بدل بستمر له العيني كبحنا جع وقد ضبط الولي لما كان وقفه	جمعه جامعياً بولها الإسلام كبار الكنائس وصلى بجمعنا واجبي باوقان كثير بحولنا وقد حرت بند وعسر اهلنا
مناقب سباب استيلاء الكفار وكيفية تحريمه وظهور العقوبات بعد وشهره للمعمر بكل منافع ولمات في العلم والعمل منا خصوصاً من سبب الكفار نجبة	وكان في العلم فخوراً اهلنا وقد حلت على من سببنا بما كان فينا من امور شهننا

تاريخها بيان
٩٥٠
و كفار

16 Nehat Krasniqi, *Kronika (Menâkib) e Tahir efendiut – burim i vëndësishëm për historinë e kulturës në Prizren gjatë periudhës turko-osmane*, në: “Edukata Islame”, nr. 57, Prishtinë, 1995, f. 59-113. I njëjti, *Kontribute Albanologjike: Studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane*, Prishtinë: Institutit Albanologjik, 2011, f. 101-103.

*Islammohuesit austriakë hynë në atdheun tonë
në vitin “gak” (1101 H./1689)¹⁷, ki në konsideratë sqarimin tonë.
Kur u shfaqën islammohuesit, u ngritën njerëzit tanë dhe luftuan
dhe u vërsulën e u përpoqën shumë.
Kur na mundën dhe erdhën në qytetin tim,
banorët tanë ikën, meqë nuk mund t’u rezistonin.
Ata mësynë të shkatërronin xhaminë e Begzades,
tri prej tyre gjetën vdekjen në të nga Zotynë.
Një e treta e pjesëve në vendin e minberit
janë gjetur tani, me sytë tanë i kemi parë.
Ata qenë trembur nga xhamia dhe e braktisën nga frika
e iu kthyen t’i shkatërronin shtëpitë e banorëve tanë.
Në këtë vend ka pasur personalitete,
kalorës të pruar si mbretërit.
Që aty e gjer tek ura, (qyteti) ka qenë i banuar,
në të dy anët e lumit rrinin banorët tanë”.*

وَمَا رَجَعْنَا غَافِقًا فَاعْتَمِرْنَا وَسَدَّوْا جَاهِدًا كَثِيرًا فَلَمْ نَعْدِرْ الدَّيْخَ نَفْرًا أَمَاتَ بِهِ مَرْوَمٌ ثَلَاثًا وَقَدْ وَجَدَتْ حَالًا ضَادًا إِلَى يَدَمِ بَيْتِ رِكَابٍ مَهْجَبٍ كَشَلْ وَجَانِبِي النَّهْرِ وَعَابِي عَشْرٍ وَقَدْ أُخْرِجُوا مِنْ وَقَدْ وَقَعَ بِرَأْسِ وَقَدْ أَعْرَجَ اللَّهُ وَمِنْ بَعْضِهِمْ إِلَى الْآلَاتِ وَبَعْدَهُ دِيْمِي	وَكُنْهَارٌ تَمَجُّجٌ فَلَمَّا بَرَا الْكُفَّارُ مَتَجَّيْ عُلْبُوا لَقَدْ تَصَدَّقُوا لَعْنَةُ مَنْ وَكَا فَوَاصِلُ وَقَدْ كَانَ فِي وَمِنْهُ إِلَى وَقَدْ حَرَّبَ وَجَاءَ إِلَى وَقَدْ أُجْرِكُوا كَذَا أَوْ كَيْتُكَ وَحَالًا فَيُجِبِينَ فِي شَرْحِ
---	---

“Populli ynë është bërë tri grupesh,
luftëtarë që luftonin me islammohuesit, me vendosmëri të fortë.

17 Viti është nxjerrë nga fjala “gak” në origjinal, sipas llogaritjes me sistemin ebxhedik.

Ruajtës të pasurisë, të familjeve e të fëmijëve
dhe një grup që largonin familjet dhe fëmijët.
Shumë prej atyre që kanë luftuar, kanë rënë dëshmorë,
kështu që familjet e fëmijët u kanë vdekur të pikëlluar.
Ata që mbetën (gjallë), u tubuan në Elbasan
dhe atje janë sëmurur e kanë vdekur banorët tanë.
Atje janë të njohura varrezat e Prizrenit
dhe ata që kuptojnë, e dinë gjendjen tonë.
Në qytet ka pasur njëzet mijë (20.000) shtëpi
dhe nuk kanë mbetur përveçse gjashtëmbëdhjetë (16).¹⁸
E ka përfunduar Zotynë me butësi e mirësi,
me ndihmën nga tatarët dhe njësitë ushtarake rreth nesh.
Janë dëbuar islammohuesit pa kurrfarë mëshire,
me ndihmën e prijatarëve të Zotërisë sonë”.¹⁹

فقدوا زناؤا خود طاعا ایستوم کاناوا	بجھونون اسلاما مشرین ووزنا
و ابادوهم کاناو بعینون صحرابا	واھھاوھم اشغ بنہم اناھانا
وقد صارتوننا ملٹھ فرقتہ	ھووب بکفار بستھ خزینا
ھغیظ طاعان و اھل واطفال	وطا لٹھ ترسل اھلا وطفانا
واکثر من حارب صھار شھیدنا	کذا الھل و الاطفال مانوا بقھرنا
الی انھضنا ما یجی یتھمھوا	وقد امرھو اھلہ و عاتوا اھلنا
وفیہ قبور برزین لشھر اور	و ھلیم من ھم اھل فرھم بحالنا
وعیشین الفھ و ازشھر لھدکان	ولم یات غیر ستھ عشر اھلنا
دھقن و لھنا بطف و ھسان	بھد و انا تار و زرین حوالھنا
وطر و کھار بھد تھ عناہہ	بھد و اصحاب الولاہ مولانا
وجاوا من الاطرف صھار و ھاجتھ	ولکن قولھ بھرھل قتل علوھنا
وکانا بھد بھرھل کھوان	واطھن من العلم صھار اھلھنا
وقد برستھ اھمارا فھننا	افصل کھف کان بھ امورنا
ننا و اھیا و حالھ بھد ترھب کھفار	دھیفھ نشتھ و اھلا تھ ھمدھ و وھرھ
بقال صھالھ زھیم و اھلھ مانوھ	وکان کنا زرھرھ فی نھنا بھنا

۱۱۱ھ

18 Ky numër i shtëpive të qytetit të Prizrenit mbase është real, nëse e krahasojmë me të dhënat, sipas të cilave Prizreni në vitin 1610 kishte 8600 shtëpi. (Noel Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, Prishtinë, Koha 1998, f. 141.) Ndërsa rreth vitit 1651, Prizreni kishte 12000 shtëpi (*Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)*. Transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputi, St. Gallen – Prishtinë, 2015, f. 415.) Rrethimisht, në vitin 1689 Prizreni do t'i ketë pasur mbi 16000 shtëpi.

19 Shih faksimilet e kësaj pjese të tekstit të përkthyer të “Kronikës” (*Menakib*) në librin tim *Kontribute Albanologjike ... Vep. e cit.* f. 123-125.

Në kohën e pushtimit të Kosovës së sotme nga habsburgët dhe aleatët e tyre, qyteti shqiptar i Prizrenit, sipas informacioneve burimore përkatëse, kishte mbi 16000 shtëpi. Nëse marrim për bazë numrin prej 7 anëtarësh për një familje, sa mesatarisht mund të jetonin në një shtëpi, rezulton se në vitin 1689 ky qytet kishte mbi 112.000 banorë, rreth 95% e të cilëve ishin shqiptarë myslimanë.

Sipas burimeve të tjera osmane, pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare myslimane të Rrafshit të Kosovës, pak para ardhjes së forcave habsburge, kishte ikur drejt Shkupit dhe, së andejmi, në Maqedoninë Lindore, kryesisht në Strumicë dhe në Serez,²⁰ ndërsa pjesa tjetër e popullsisë shqiptare myslimane e Rrafshit të Dukagjinit do të ketë ikur bregut të Drinit, kah Gryka e Lumës, në drejtim të Elbasanit, andej nga kishin ikur banorët e Prizrenit.²¹ Burimet thonë se vetëm një e treta (1/3) e popullsisë shqiptare myslimane e këtyre viseve kishte mundur të shpëtonte nga vdekja.²²

Forcat e “Aleancës së Shenjtë” me gjithë vullnetarët e tyre të krishterë kishin dëmtuar rëndë vendbanimet e popullsisë shqiptare myslimane të sanxhaqeve të Vushtrrisë, Dukagjinit, Prizrenit dhe të Shkupit, duke i plaçkitur, djegur dhe rrënuar shumicën dërmuese të tyre. Dëmtimet më të rënda i kishin pësuar qytetet që ishin seli të sanxhaqeve. Vuçitërna (Vushtrria), pas kësaj kohe, për shkak të dëmtimeve të mëdha që kishte pësuar, nuk mund të ishte më qendër e sanxhakut, kështu që selia e sanxhakut kaloi përgjithmonë në Prishtinë. Tanimë, ky sanxhak kishte humbur përfundimisht dhe pa gjurmë njëren nga gjashtë qendrat e kazave të tij, kasabanë Kosova që ishte në veri të Prishtinës, në rajonin e Llapit. Gjithashtu edhe Peja, Prizreni dhe Shkupi, si qendra sanxhaku, ishin dëmtuar dhe rrënuar pothuajse tërësisht. Dëmtime të mëdha kishin pësuar gjithashtu kështjellat dhe minierat. Kështjella dhe miniera Kosova e Llapit ishin rrënuar për t’u harruar përgjithmonë.²³ Kështjella dhe miniera e Novobërdës, bashkë me shtëpitë e shqiptarëve myslimanë, ishin dëmtuar shumë. Miniera Trepça, me gjithë kasabanë me të njëjtin emër, ishte rrënuar aq shumë, sa ishte bërë e papërdorshme.

Në krye të qeverisë osmane në këtë kohë, që karakterizohet si një ndër momentet më kritike në periudhën e tatëpjetës së saj, më 25 tetor të vitit 1689, erdhi Fadil Mustafa pashë Qypërliu. Falë aftësive organizative dhe drejtuese të tij, ushtria osmane arriti ta rimerrte veten, të konsolidohej dhe të fillonte të vepronte me sukses në frontin e luftës në Rumeli.²⁴ Hapi i parë që ndërmori ai, ishte heqja e disa tatimeve të jashtëzakonshme, të cilat godisnin rajën e Gadishullit Ballkanik. Krahas kësaj, Fadil Mustafa pasha reduktoi shpenzimet administrative të aparatit shtetëror.

20 Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2008, f. 129.

21 Nehat Krasniqi, *Kontribute Albanologjike...*, Vep. e cit, f. 103.

22 Süleyman Külçe, *Osmanlı tarihinde Arnavutluk*, Izmir, 1944, f. 103.

23 Skender Rizaj, *Rударство Kosova i susednih krajeva od XV do XVII veka*, Priština, 1968, f. 165.

24 Skender Rizaj, *Historia e Përgjithshme – Koha e Re (1453-1789)*, Prishtinë, 1985, f. 258.

Pas këtyre hapave, më vonë, në verën e vitit 1690, ai ndërmoi një fushatë ushtarake kundër habsburgëve. Kështu, më 9 shtator, habsburgëve ua mori Nishin, për t'ua marrë pastaj, më 27 shtator, Smederevën, kurse më 8 tetor edhe Beogradin.²⁵

Në dimrin e vitit 1689, Fadil Mustafa pashë Qypërliu shpalli mobilizim të përgjithshëm (*nefriām*) në Shqipëri. Për ta kryer sa më mirë këtë mobilizim, ai u dha detyra të caktuara pashallarëve më autoritarë shqiptarë të kohës, si bejlerbeut të Halepit, vezirit Arnaut Koxha Halil pashë Shkupit (kryekomandant), bejlerbeut të Rumelisë, vezirit Xhafer pashë Vlora, sanxhakbeut të Shkodrës, vezirit Sylejman pashë Bushatit dhe mytesarifit të Prizrenit dhe Dukagjinit, Mahmud pashë Mahmutbegollit.²⁶

Në fillim të janarit të vitit 1690, forcat e sanxhakbejlerëve shqiptarë, në bashkëveprim me forcat tatarë të hanit të Krimesë, korrën fitore ndaj forcave habsburge dhe i dëbuan ato nga viset e Maqedonisë së sotme dhe nga Kosova. Fillimisht, eliminuan Karposhin dhe anëtarët e bandës së tij, të cilët kishin bërë krime të papara mbi popullsinë shqiptare myslimane të Maqedonisë së sotme, pastaj u drejtuan kah Kaçaniku. Ndër pashallarët shqiptarë që kanë marrë pjesë me forcat e tyre në luftime kundër habsburgëve në rrethinën e Shkupit, gjatë dimrit të vitit 1689-90 dhe në betejën e Kaçanikut, më 1 e 2 janar të vitit 1690, kanë qenë bejlerbeu i Halepit, Arnaut Koxha Halil pashë Shkupi me 15000 shqiptarë të sprovuar në luftime, muhafizi i Shkupit, Koxha Mahmud pashë Gjakova, bejlerbeu i Rumelisë, Mustafa pashë Zurnapa, mytesarifi i Vlorës, Arnaud Xhafer pasha, sanxhakbeu i Dukagjinit, Mahmut pashë Mahmutbegolli i Pejës.²⁷ Kryekomandanti dhe veziri shkupjan Arnaut Koxha Halil Pasha, bashkë me Selim Giraj Hanin e Krimesë, ishin në ballë të ushtrive që marshuan drejt Grykës së Kaçanikut në Kosovë. Me ta ishte edhe *serhadlu* (*komandanti kufitar*), Mehmet pashë Hasan beg-zadeja nga Gjakova.²⁸ Të gjithë këta sanxhakbejlerë me ushtritë e tyre nga Shkupi shkuan në Grykën e Kaçanikut, ku u ndeshën me forcat habsburge të komanduara nga koloneli Shtraser, duke u shkaktuar atyre disfatë të thellë. Forcat habsburge në këtë betejë numëronin 12.000 trupa të zgjedhura dhe kishin në dispozicion 45 topa të ashtuquajtura “*Shahi*”.²⁹

Pas fitores që korrën në betejën e Kaçanikut, forcat e bashkuara të sanxhakbejlerëve shqiptarë, së bashku me ato të hanit të Krimesë, i ndoqën habsburgët edhe nga Prizreni, Gjakova, Peja dhe Prishtina.³⁰ *Serhadlu* - Mehmet pashë Hasan beg-zadeja i Gjakovës, me forcat e tij shqiptare, së bashku me Kallgaj Devlet Giraj

25 Robert Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë, Dituria, 2004, f. 239.

26 Süleyman Külçe, *Osmanlı tarihinde Arnavudluk*, Izmir, 1944, f. 104.

27 Silahdar Mehmet Ağa, *Silahdar Tarihi*, II, Istanbul, 1928, f. 492.

28 T. Yılmaz Öztuna, *Başlangıcından zamanımıza kadar Türkiye Tarihi*, 10 cilt, /Istanbul/: Hayat Yayınları, 1966, f. 120.

29 Silahdar Mehmet Ağa, *Silahdar Tarihi*, f. 492.

30 Mehmet Ağa, *Silahdar Tarihi*, f. 494.

(Kalgay Devlet Giray), në krye të forcave tatare, afër Prizrenit ngadhënjyen mbi një forcë ushtarake prej 8000 vetash, të cilët në gjokset e tyre mbanin kryqin si simbol, sikurse në luftërat e Kryqëzatore.³¹

Me ushtrinë habsburge, nga Kosova ikën edhe aleatët e krishterë shqiptarë e serbë, të udhëhequr nga kleri i lartë i tyre dhe të motivuar nga frika e hakmarrjes së shqiptarëve myslimanë, ndaj të cilëve kishin bërë krime të papara. Numri i aleatëve habsburgas dhe familjarëve të tyre të shpërngulur serbë, shqiptarë, bullgarë e të tjerë, nga i gjithë Ballkani, arrinte nga 20.000 deri në 30.000 njerëz.³² Ndërsa numri i të shpërngulurve të krishterë nga Kosova e sotme dhe viset shqiptare përreth saj, nuk shkonte më shumë se 10.000 veta, pjesa më e madhe e të cilëve ishin shqiptarë ortodoksë dhe katolikë, kurse pjesa tjetër, më e vogël, ishin rashanë (serbë).³³ Lidhur me këtë ikje, historiografia serbe, e cila është mjaft analogjike me ikjen e serbëve nga Kosova, pas përfundimit të luftës çlirimtare (1999), të paktën për nga motivi i frikës së hakmarrjes nga popullsia shqiptare, ndaj së cilës kishin bërë krime, ka sajuar hipotezën për të ashtuquajturën “Dyndja e madhe serbe” nga Kosova.

Në nëntor të vitit 1690, pas rimarrjes së Nishit, Beogradit dhe territoreve të tjera, deri në Osjek, sadriazemi Fadil Mustafa pashë Qypërliu i ftoi qytetarët e krishterë, të ikur nga vatrat e tyre, që të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe të merrnin tokat e tyre.³⁴ Një numër të krishterësh ortodoksë që ishin shpërngulur nga viset shqiptare të Veriut, të pakënaqur me trajtimin armiqësor nga autoritetet habsburgase dhe nga Kisha Katolike, ishin kthyer në këto territore në gjysmën e parë të vitit 1691.³⁵

Nuk kaluan as njëmbëdhjetë vjet pas Traktatit të Paqes, të lidhur në Karlovac të Sremit, më 26 janar 1699, ndërmjet osmanëve në njërën anë dhe të austriakëve, venedikasve dhe polakëve, më vonë, më 15 korrik 1700, edhe të rusëve, nga ana tjetër, përsëri, gjatë viteve 1710-1739, ndodhën luftëra të reja me Rusinë, Austrinë dhe me Venedikun.³⁶ Edhe këto luftëra nuk kaluan pa pasoja për popullin shqiptar dhe për trojet shqiptare. Shqetësime, rirreshtime, përplasje dhe lëvizje të popullatës në trojet shqiptare të Veriut solli sidomos lufta habsburge-osmane e viteve 1737-1739.³⁷

Krahinat shqiptare të përfshira në luftërat e fundshekullit XVII dhe të fillimshkullit XVIII, pësuan shkatërrime, masakra, arratisje të popullsisë dhe rrënim të përgjithshëm.³⁸ Këto luftëra, bashkë me epideminë e murtajes, morën me vete

31 T. Yılmaz Öztuna, *Başlangıcından zamanımıza kadar ... Vep. e cit.*, f. 120.

32 Skender Rizaj, *Historia e Përgjithshme ... Vep. e cit.*, f. 259; Noel Malcolm, *Kosova – një histori e shkurtër*, Prishtinë, Koha, 1998, f. 166.

33 *Historia e Popullit Shqiptar I*, f. 583.

34 *Dokumente të Shekujve XVI- XVII për Historinë e Shqipërisë, Vep. e cit.*, f. 356-357.

35 Noel Malcolm, *Kosova- një histori...* Vep. e cit. f. 170.

36 Zhil Veinshtein, *Provincat Ballkanike (1600-1774)*, në: *Historia e Perandorisë Osmane* Nën drejtimin e Robert Mantran, Tiranë: Dituria, 2004, f. 288.

37 I. Hakki Uzunçarşılı, *Büyük Osmanlı Tarihi*, V.cilt, 6.basku, /s.l., s.a./, f. 268-272.; Nikolla Jorga, *Histori e shkurtër e Shqipërisë dhe e Popullit Shqiptar*, Tiranë; Saraçi, 2004, f. 124.

38 Jorga, *Histori e shkurtër e Shqipërisë dhe e Popullit Shqiptar*, f. 299.

një pjesë të madhe të popullsisë shqiptare, shpopullimi i së cilës do të ndihet për një kohë të gjatë, sidomos në Kosovë.

Një pasqyrë mjaft të qartë të gjendjes së përgjithshme ekonomike, demografike dhe të sigurisë në Kosovë, në kohën e pushtimit të saj nga forcat habsburge dhe aleatët e tyre, na paraqet peticioni (mazbata) e ulemasë dhe parisë së kasabasë së Prishtinës, Vëlçetrinës (Vushtrrisë), Novabërdës (Novobërdës), Janovës së Vjetër (Janjevës) dhe të Moravës (Gjilanit), drejtuar Portës së Lartë, më 29 mars të vitit 1695. Për shkak të rëndësisë që ka ky dokument, i pa vërejtur nga historianët tanë dhe i pa botuar më parë, po e sjellim të përkthyer në gjuhën shqipe.

“Ulemaja, besimtarët dashamirës, të dobëtit dhe robërit e varfër të kasabave të Prishtinës, Vëlçetrinës, Novabërdës, Janovës së Vjetër dhe të Moravës, të cilat ndodhen brenda Kosovës, nëpërmjet këtij peticioni, i parashtrojnë strehimores së Portës së Drejtësisë (Portës së Lartë: N. K.), që është streha e njerëzimit, sa vijon: Kohë më parë, kur vendin tonë e pushtuan dinmohuesit (Habsburgët dhe aleatët e tyre: N. K.), të gjithë ne, së bashku me njerëzit dhe me familjet tona, u degdisëm e u mjeruam dhe ikëm në vende të tjera. Duke qenë secili prej nesh të vendosur në një vend tjetër, me ndihmën e Zotit të Lartmadhërisëm, vilajeti ynë u çlirua dhe hyri brenda pushtetit islam. Me urdhër të lartë, ne robërit u kthyem prapë dhe u vendosëm duarthatë në tendat tona. Midis nesh, ata që kishin mundësi, kanë shitur veshmbathjet e gjësendet me vlerë dhe me hua kanë blerë nga vendet e tjera farën (për mbjellje: N. K.) dhe qetë (për lëvrimin e tokës: N. K.). Nja dy vjet u morëm me bujqësi dhe me çifçillëk, duke kaluar me varfëri e skamje, deri kur më tepër se dymijë (2000) kalorës të rëndë hungarezë dhe hajdutë keqbërës,³⁹ përsëri shkelën kasabatë dhe vilajetin tonë. Disa nga tanët u zunë robër, disa ranë dëshmorë dhe shtëpitë tona u dogjën përsëri. Ata të llojit të egërsirave që gjendeshin nën mbrojtjen tonë, i tërhoqën dhe i çuan në atë vend ku mjaft nga tanët u degdisën dhe u mjeruan. Ne që kemi mbetur në atdheun e ndritur, kemi ngelë të vobektë dhe të dëmtuar. Kjo u bë shkak i vendimit tonë, për ta njoftuar me shkrim Portën e Lartë për gjendjen tonë, që të kihet dhembshuri për gjendjen tonë dhe të mbrohet vilajeti ynë. Por ka dy vjet që në vilajetin tonë jemi të shtrënguar nga zia e bukës dhe shtrenjtësia, kështu që është bërë e nevojshme që drithërat dhe ushqimet tona t'i sjellim nga vendet e tjera. Kështu, përveç që jemi detyruar të paguajmë çmimin e shkallës më të lartë për çështjet tona jetësore, në anën tjetër, edhe këtë vit në anët tona hajdutët dhe keqbërësit e kanë bërë shqetësuese gjendjen tonë individuale dhe masive. Prandaj, kohë më parë, janë dërguar njerëz të caktuar që kreut të Portës së Drejtësisë (Sulltanit: N. K.) t'i kumtojnë ankesat tona, me lutjen që edhe këtë vit vilajeti ynë të ketë mirësinë dhe të mbrohet. Në u lejofitë, jemi të gatshëm ta presim vendimin, në mos u lejofitë, jemi të gatshëm të presim shkatërrimin tonë. Në këtë kohë ka arritur

39 Fjala osmane *esbkëjâ* (*eşkiyâ*) ka domethënie: keqbërës; hajdut, kusar, rebel. Duket se që nga kjo kohë, ka filluar të përdoret nga popullsia shqiptare myslimane e Shqipërisë së Sipërme, në trajtën ‘shkâ’, ‘shkjâ’, si sinonim i fjalës ‘serb’.

fermani (urdhri sulltanor: N. K.), sipas të cilit këtë vit, nga rrethinat e Shkupit dhe të Kosovës, duhet të blihen dymbëdhjetëmijë (12.000) kile stambollase (307.906 kg.: N. K.) drithërash të përzier. Është qartë e dukshme, se këta robër të varfër, duke qenë të nevojshëm për energjinë (kafshatën: N. K.) ditore, nuk kemi fuqi ekonomike që të mbledhim kaq drithëra të përzier dhe kaq kafshë transportuese. Nisma për njoftimin e Portës së Lartë u bë me sigurinë se do të na falë e mëshirojë Sulltani, e jo nga frika se do të hidhërohet me ne dhe do të na ndëshkojë për pamundësitë tona për ta zbatuar fermanin. Aktualisht, pesë kazatë e përmendura të Kosovës kanë nga pesëmbëdhjetë palë fshatra me nga një deri në dy shtëpi, po ashtu edhe kasabatë e përmendura kanë nga pesë deri në dhjetë shtëpi të mbetura të neve robërve myslimanë. Nëse të gjithë ne do të vinim në një vend dhe të uritur do të parapëlqenim vdekjen tonë e do të jepnim tërë prodhimtarinë bujqësore që zotërojmë, nuk është e mundur t'i arrijmë 200 /kile⁴⁰ stambollase (afro 5000 kg.: N. K.) drithërash të përzier. Sa i përket kafshëve transportuese, përveç kafshëve ngarkuese të timariotëve tanë që janë luftëtarë, nga kasabatë dhe fshatrat tona nuk mund të bëhen dhjetë krerë kafshë transportuese. Varfëria dhe nevojat tona janë të një shkalle të atillë, që mundësitë tona nuk janë as të vendimit, as të dezertimit. Jemi robërit e vendit të mëshirës. Për hir të Zotit të Lartësuar dhe të Profetit fisnik, kini mëshirë për gjendjen e këtyre robërve të varfër dhe të dobët, që të mos na ngarkoni me këtë detyrim të vështirë, por të na lironi dhe kështu, të fitoni një sevap të madh! Titullarit të Portës së Drejtësisë (sulltanit: N. K.) - urdhrin dhe fermanin të përjetshëm dhe mëshirës, dhembshurisë dhe mirësisë së pafund.

Kazaja e Prishtinës: Mehmed hatibi, Mustafa hatibi, Haxhi Mustafa hatibi, Mustafa hatibi, Ibrahim imami, Mehmed imami, Hasan myezini, Hysejn myteveliu, Haxhi Mehmed pensioneri, Ali koloneli aktual, Mustafa ish koloneli, Mustafa pensioneri, Osman zaimi, Skënder pensioneri, Ymer bakalli, Ahmed këpucari, Ali kazazi.

Kazaja e Vuçitërnës: Mehmed hatibi, Ibrahim hatibi, Hasan hatibi, Hysejn imami, Ibrahim imami, Ahmed imami, Emrullah myezini, Haxhi Selim myezini, Mehmed pensioneri, Haxhi Shabani, Jusufi, Haxhi Ahmedi, Ibrahim, Sejdiu, Mustafa, Ahmed bakalli, Aliu, Mehmedi, Ahmed bukëpjekësi.

Kazaja e Novobërdës: Mehmed hatibi, Ali sejjidi, Mustafa imami, Mahmud imami, Ahmed myezini, Ali myezini, Ahmed myteveliu, Mustafa dizdari, Hysejn bajraktari, Mustafa mbrojtësi, Ismail mbrojtësi, Osman mbrojtësi, Halil mbrojtësi, Ibrahim mbrojtësi.


Kazaja e Janjevës: Jusuf hatibi, Ali imami, Ahmed myezini, Ismail myezini, Ibrahim emigranti, Muharrem ushtaraku, Mustafa këpucari, Mehmed bukëpjekësi.⁴¹

Më 13 Sha'ban 1106 H./ 29 mars 1695⁴².

40 Fjala 'kile' mungon në dokument.

41 Të gjithë këta persona, nën emrin dhe profesionin e tyre, kanë vënë vulat (myhyrët) personale.

42 T. C. Başbakanlık Osmanlı Arşivi: AE. SAMD. II Dosya No 5 Gömlek sıra No 455. (Shih faksimilen në vazhdim).



Ky dokument tregon qartë për ikjen e popullsisë shqiptare myslimane të këtyre pesë kazave të Kosovës nga ushtria habsburge dhe aleatët e vullnetarët e saj të krishterë, si dhe për degdisjen dhe mjerimin e kësaj popullsie në vende të huaja. Dokumenti tregon se, pas shporrjes së ushtrisë së "Aleancës së Shenjtë" nga Kosova,

një pjesë e vogël e popullsisë shqiptare myslimane, që për shkaqe lufte ishte arratisur, ia kishte dalë mbanë të kthehej në atdhe, ku kishin gjetur shtëpitë të djegura e të rrënuara, për çka, duarthatë, ishin vendosur nëpër tenda. Dy vjet më vonë, sapo kishte filluar ta merrte veten kjo popullsi, pas shumë vuajtjesh e sakrificash, në këto vise të Kosovës depërtoi furishëm një trupë prej mëse 2000 kalorësish të rëndë hungarezë dhe hajdutësh keqbërës, të cilët, pasi vranë disa, zunë robër disa të tjerë dhe dogjën përsëri shtëpitë e kësaj popullsie, bashkë me robërit e zënë, tërhoqën me vete edhe një grup të krishterësh të këtyre viseve. Për këtë depërtim të kësaj trupe kalorësish dhe për tërheqjen e një numri banorësh të krishterë nga këto vise, ky dokument sjell informacione të reja, të panjohura më parë. Nga ky dokument shohim se 5 kazatë e përmendura të Kosovës, në vitin 1695 numëronin nga 15 fshatra, që gjithsej bëjnë 75 fshatra me maksimalisht 150 shtëpi shqiptare myslimane. Ndërsa në 5 kasabatë (qytezat) e përmendura të Kosovës, të cilat ishin qendra të sanxhaqeve të përmendura, kishin mbetur maksimalisht 50 shtëpi. Kështu, del se në këto 5 kaza të Kosovës, në vitin 1695 kishin ngelur jo më shumë se 200 shtëpi shqiptare myslimane. Nëse marrim për bazë numrin prej 7 anëtarësh për një familje, sa mesatarisht mund të jetonin në një shtëpi, rezulton se në vitin 1695, në këto pesë kaza të Kosovës kishin mbetur rreth 1400 banorë shqiptarë të besimit islam.

Ky dokument, kronika e Prizrenit (*Menâkib*) e Tahir efendiut dhe burime të tjera që u përmendën më lart, dëshmojnë për një dyndje të madhe të popullsisë shumicë shqiptare myslimane nga sanxhaqet e Prizrenit, Dukagjinit, Vuçitërnës dhe Shkupit, respektivisht nga Kosova e sotme dhe nga viset me popullsi shumicë shqiptare të Maqedonisë së sotme, nga mesi i tetorit deri në fillim të nëntorit të vitit 1689. Ky dokument dhe burime të tjera dëshmojnë për plaçkitje, rrënimë, djegie të vendbanimeve të popullsisë shqiptare myslimane të Kosovës së sotme dhe të Maqedonisë së sotme në këtë kohë nga trupat habsburge dhe nga trupat vullnetare nga radhët e popullsisë të krishtera të viseve ballkanike. Ky dokument dhe burime të tjera dëshmojnë katërçipërisht për një shpopullim tejet të madh të Kosovës së sotme dhe të viseve të tjera etnike shqiptare përreth saj, që kishte ndodhur në atë kohë. Ky shpopullim kishte ndodhur si pasojë e vrasjes dhe e vdekjes nga uria dhe nga sëmundjet të mbi dy të tretave ($\frac{2}{3}$) të popullsisë shqiptare të këtyre viseve. Por, si për ironi, historiografia serbe mbi këtë fatkeqësi të madhe të shqiptarëve ka ngritur hipotezën e shpifur dhe tejet djallëzore për të ashtuquajturën “Dyndje të madhe serbe” nga Kosova. Këtë hipotezë të historiografisë serbe, të mbështetur edhe nga ndonjë historian evropian, madje edhe nga ndonjë nxënës shqiptar i shkollës historiografike serbe, qysh herët, me të drejtë, e ka hedhur poshtë Profesor S. Rizaj, si të papabazë, joshkencore dhe të papranueshme.⁴³

43 Skënder Rizaj, *Mbi të ashtuquajturën dyndje e madhe serbe nga Kosova në krye me patrikun Arsenije Çarnojeviq (1690)*, në: Gjurmime Albanologjike – Seria e Shkencave Historike, XII – 1982, Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1983, f. 81-103.

Përfundim

Disfata ushtarake osmane para mureve të Vjenës, më 12 shtator të vitit 1683, shënon një ngjarje historike të rëndësishë së veçantë. Kjo disfate shënon një moment kthese dhe ndryshimi të thellë në raportet midis Perandorisë Osmane dhe Europës. Luftërat e gjata dhe dramatike ndërmjet Perandorisë Osmane dhe fqinjëve të saj evropianë, në kapërcyellin e shekullit XVII dhe në katër dekadat e para të shekullit XVIII, kanë shkaktuar tronditje dhe një varg ndryshimesh edhe brenda shtetit dhe shoqërisë osmane. Me rëndësi të veçantë për zhvillimin historik të etnisë shqiptare e të viseve etnike shqiptare të Perandorisë Osmane në përgjithësi dhe të Kosovës së sotme në veçanti, janë ndryshimet në sistemin politik dhe në sistemin ekonomik osman të fillimit të shekullit XVIII. Me ndryshimet në sistemin politik, sidomos me njohjen e pushtetit të trashëgueshëm në sanxhaqet shqiptare, jo vetëm që është decentralizuar pushteti osman, por janë krijuar kushtet për konsolidimin e oxhakërisë apo fisnikërisë shqiptare dhe për formimin e elitës politike shqiptare. Ndërsa, me ndryshimet në sistemin ekonomik shoqëror osman, përkatësisht në sistemin agrar juridik, që solli përfundimisht mbizotërimin e sistemit çiflig–sahibinj (*çiflik–sâhibîler*), mbi sistemin timar–spahinj (*timâr–sipâhîler*), u krijuan kushtet për lindjen e shtresës së çifligarëve të mëdhenj dhe të ajanëve shqiptarë, si dhe për fuqizimin ekonomik të elitës politike shqiptare. Viset të përfshira nga flakët e luftërave midis forcave të “Aleancës së Shenjtë” dhe atyre osmane, në veçanti viset e Kosovës së sotme dhe viset e tjera etnike shqiptare të Sanxhakut dhe të Maqedonisë së sotme, kanë përjetuar pasojat më të rënda dhe më të thella të këtyre luftërave. Burimet që kemi konsultuar, hedhin dritë të re për zhvillimet e këtyre luftërave, për rolin e shqiptarëve në këto luftëra, si dhe për rrethanat politike, ekonomike e sociale të popullsisë shumicë shqiptare në këto vise. Këto burime hedhin dritë të re edhe për pasojat tejet të rënda që sollën këto luftëra për qenien etnike shqiptare dhe për të mirat materiale e kulturore të kësaj etnie në Kosovën e sotme. Hedhin dritë të re sidomos për lëvizjet demografike dhe për shpërnguljet e popullsisë shqiptare nga Kosova e sotme. Të dhënat që sjellin këto burime, janë dëshmi e qartë për shpopullimin tejet të madh të etnisë shumicë shqiptare në Kosovën e sotme, si pasojë e numrit të madh të vrasjeve dhe të vdekjeve nga uria, nga sëmundjet dhe nga epidemia e murtajes të pothuaj dy të tretave ($\frac{2}{3}$) të popullsisë shqiptare të Kosovës së sotme. Këto të dhëna hedhin poshtë përfundimisht hipotezën e shpifur të historiografisë serbe mbi të ashtuquajturën “Dyndje të madhe serbe nga Kosova” dhe pasojat e saj në strukturën demografike etnike të vendit. Burimet osmane dëshmojnë se popullsia serbe në Kosovë, gjatë shekujve osmanë, ka qenë pakicë dhe nuk ka pasur asnjë rol të rëndësishëm në zhvillimin historik të vendit, sidomos nga fundi i shekullit XV, deri në gjysmën e shekullit XIX.

Referencat

- Jorga, Nikolla, *Histori e Shkurtër e Shqipërisë dhe e Popullit Shqiptar*, përktheu nga frëngjishtja: Viron Koka, Tiranë: Saraçi, 2004.
- Krasniqi, Nehat, *Kronika (Menâkib) e Tahir efendiut – burim i rëndësishëm për historinë e kulturës në Prizren gjatë periudhës turko-osmane*, në: “Edukata Islame”, nr. 57, Prishtinë, 1995.
- Krasniqi, Nehat, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII, deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017.
- Külçe, Süleyman, *Osmanlı tarihinde Arnavutluk*, Izmir, 1944.
- Malcolm, Noel, *Kosova – një histori e shkurtër*, Prishtinë, Koha, 1998.
- Mantran, Robert, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë, Dituria, 2004.
- Mehmeti, Sadik, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2008.
- Öztuna, T. Yılmaz, *Başlangıcından zamanımıza kadar Türkiye Tarihi*, 10 cilt, /Istanbul/: Hayat Yayınları, 1966.
- Rizaj, Skender, *Historia e Përgjithshme – Koha e Re (1453-1789)*, Prishtinë, 1985.
- Rizaj, Skender, *Rudarstvo Kosova i susednih krajeva od XV do XVII veka*, Priština, 1968, f. 165.
- Rizaj, Skënder, *Mbi të ashtuquajturën dyndje e madhe serbe nga Kosova në krye me patrikun Arsenije Çarnojeviq (1690)*, në: Gjurmime Albanologjike – Seria e Shkencave Historike, XII – 1982, Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1983.
- Sertoğlu, Midhat, *Resimli Osmanlı Tarihi Ansiklopedisi*, Istanbul Matbaası, 1958.
- Silahdar, Mehmet Ağa, *Silahdar Tarihi*, II, Istanbul, 1928.
- Stanojević, Gligor, *Srbija u vreme Bečkog rata (1683-1699)*, Beograd, Nolit, 1976.
- Shaw, Stanford J., *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë: Jehona Study Center, 2006.
- Veinshtein, Zhil, *Provincat Ballkanike (1600-1774)*, në: *Historia e Perandorisë Osmane* Nën drejtimin e Robert Mantran, Tiranë: Dituria, 2004.
- Zinkeisen, Johann Wilhelm, *Osmanlı İmparatorluğu Tarihi (1669-1774) 5*, Istanbul: Yeditepe, 2011.

The aftermath of the Habsburg-Ottoman wars in the demographic structure of Kosovo

Abstract

This paper focuses on the development and consequences of the Habsburgs - Ottoman wars in today's Kosovo and the other ethnic Albanian areas of Sandžak, as well as of today's Macedonia, at the turn of the XVII century and in the first four decades of the eighteenth century. This study highlights the role of Albanians in these wars, and in particular, the extremely serious consequences that these hostilities had on the majority of Albanian population inhabiting these areas. Indeed, Ottoman sources that were previously unknown to the Albanian historiography and beyond, have shed fresh new light on the circumstances moulded in those areas, at the time of the subversion of the Habsburg forces and their allies during the last quarter of 1689. They shed first-hand light, particularly on the demographic discrepancies and the massive displacement, of the Albanian Muslim population from today's Kosovo at that particular time. These sources express very plainly the enormous depopulation of ethnic Albanian majority in today's Kosovo and surrounding areas all through these conflicts, as a result of displacements, murder, death from starvation, disease and eventually plague epidemics, which at that time ultimately annihilated almost two thirds of the Albanian population of today's Kosovo.

Key words: Albania, Kosovo, population, Ottoman Empire, Muslim, demography